



## Raporti i transparencës 2018

*Vlera të larta teorike - profesionale në një shërbim që ofrohet me çiltërsi dhe fines.*

# FINES

## Përmbajtja

Kush jemi ne.....	2
Struktura funksionale dhe sistematizimi i stafit .....	3
Sistemi i kontrollit të cilësisë .....	3
Lista e njësive ekonomike me interes publik .....	3
Informacioni financiar .....	3
Deklarata e praktikave të pavarësisë të shoqërisë audituese .....	4

## Kush jemi ne

Stafi ynë përbëhet nga Auditues ligjorë dhe kontabël të miratuar. Në përbërje të stafit ka anëtarë me formim të lartë profesional dhe teorik.

Zj. Enkeleda Stefani zotëron titullin e Auditues Ligjor, ka një eksperience 20 vjeçare në fushën e financës dhe kontabilitetit dhe 10 vjet në auditim. Veç kualifikimeve si kontabiliste e miratuar dhe audituese ligjore ajo vazhdon zhvillimin profesional si studente e ACCA si dhe trajnime të tjera të zhvilluara nga institucione të fushës.

z. Edvin Stefani me një eksperiencë të gjatë në administratën tatimore dhe atë në fushën e auditimit, zotëron gradën “Doktor i shkencave” në fushën ekonomike, me specializim në taksim. Autor i librit “Taksimi normativ” (2018) dhe “Taksimi Pozitiv” (2020), të vetmit libra për taksimin në Shqipëri, ku trajtohen teorikisht dhe praktikisht të gjithë detyrimet tatimore në sistemin tatimor shqiptar.

## Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë vlerë të shtuar, duke u angazhuar në ndershmëri, dedikim ndaj rritjes së vijueshme të cilësisë së shërbimeve, transparencë dhe përgjegjshmëri.

## Vizioni

Vizioni ynë ka të bëjë me përafrimin me standardet më të mira profesionale duke u bërë një shembull për transparencën dhe duke synuar integritetin profesional dhe përgjegjshmërinë.

## Strategjia

Trajnimi i vijueshëm profesional dhe angazhimi në një kulturë pune gjithë përfshirëse. Në shërbim të kësaj strategjie realizohet analizë periodike e risqeve të brendshme dhe të jashtme, duke u ndërmarrë njëkohësisht plan-veprime për përmirësim të vazhdueshëm.

FINES është një kompani shqiptare me qendër në Tiranë. Klientela e saj shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Nuk ka degë dhe asociime. Fines ka partner angazhimi në punën audituese Zj. Enkeleda Stefani e cila është regjistruar në regjistrin kombëtar të IEKA me nr. regjistri 208.

## Pronësia, Struktura funksionale dhe sistematizimi i stafit

Njësia zotëron personalitetin juridik të personit fizik. Ajo është krijuar në tetor 2007, në Tiranë. Adresa aktuale është Njësia Administrative, Nr.5, Rruga Vaso Pasha, Ndërtesa nr.22, Hyrja Nr.23, Apartamenti Nr.4. Kodi postar nr.1019, Tiranë.

Njësia ka Kodin e saj të Etikës, Rregullore të rekrutimit dhe e menaxhimit të personelit, rregullore të procedurave të auditimit, Rregullore për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizimit, të botuara në faqen e saj të internetit.

Në thelb ofrohen tre shërbime. Ata janë auditimi, kontabiliteti dhe konsulenca . Në përputhje me këto funksione kompania ka një strukturë të sheshtë dhe tre degë, secila për funksionin përkatës. Në auditim janë angazhuar dy punonjës, në kontabilitet tre punonjës dhe në konsulencë një punonjës. Në shoqërinë tonë vlerësohen trajtimi i vijueshëm dhe aftësi personal dhe njerëzor. Për këtë arsye zhvillohen trajtime periodike në fushën e auditimit, standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit, si dhe në fushën e taksimit.

## Sistemi i kontrollit të cilësisë

Sistemi bazohet në standardet ndërkombëtare të auditimit. Duke qenë një shoqëri e vogël kontrolli i cilësisë paraqet avantazhe në përfitimin e cilësive maksimale. Fines ka rregullore të brendshme dhe kod të etikës, rregullore të rekrutimit dhe menaxhimit të personelit, rregullore për parandalimin e pastrimit të parasë.

Sistemi synon sigurimin e cilësisë më të mirë duke vështuar maksimizimin e vijueshëm të saj. Në përputhje me këtë realizohet kontrolle periodike.

## Lista e njësive ekonomike me interes publik

Në vitin 2018 është realizuar auditimi i “Buka” sh.a që janë zhvilluar në bashkëpunim me shoqëri auditimi.

## Informacioni financiar

në mijë lekë

	2018	2017
Auditim ligjor	2,595	3,010
Të tjera	1,328	410
<b>Totali</b>	<b>3,923</b>	<b>3,420</b>

## Deklarata e praktikave të pavarësisë të shoqërisë audituese

Stafi drejtues i FINES është i ndërgjegjshëm se cilësia në shërbimin e auditimit përbën një limit, i cili kërkon përpjekje të vazhdueshme. Në përputhje me këtë qasje është ngritur procedurë për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë e cila është bërë dhe pjesë e rregulloreve të brendshme. Gjithashtu janë zhvilluar kontrole periodike të vetëvlerësimit.

Duke marrë të gjithë këto evidenca së bashku, drejtuesit e FINES konfirmojnë me një shkallë sigurie të arsyeshme se sistemet e kontrollit të cilësisë janë realizuar efektivisht për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018.

Gjithashtu është realizuar një regjistrim i risqeve me të cilat përballet shoqëria dhe janë ndërtuar plan veprimet për përmirësim të gjendjes.